



8 Orë në Parajsë

nga **Ricardo Cid**

www.DivineRevelations.info/Albanian

Zoti thotë: ***“Po u dërgoj këtë mesazh njerëzve të Mi në Tokë, sepse Unë ekzistoj në vendet qiellore.”***

Zbulesa 4:1

Pas këtyre gjërave, pashë dhe ja, një derë u hap në qiell dhe zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua si bori, tha: "Ngjitu këtu dhe do të të tregoj gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave."

Zbulesa 5:11

Pastaj pashë, dhe dëgjova zërin e shumë engjëjve përqark fronit, qenieve të gjalla dhe pleqve; dhe numri i tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë mijërash dhe mijëra mijërash, që thoshin me zë të madh: "I denjë është Qengji që u ther, të marrë fuqinë, dhe pasurinë, dhe diturinë, dhe forcën, dhe nderin, dhe lavdinë, dhe bekimin."

I lutem kishës të dëgjojë se çfarë ndodhi në jetën time. Zoti mu drejtua me anë të një ëndrre. Në atë ëndërr, mbaj mend që dola nga shtëpia dhe nisa të ecë në rrugët e lagjes. Në një moment ndjeva se dikush më kapi për dore dhe më çoi lart në qiell. Unë nisa të vrapoj mbi re dhe i jepja lavdi Perëndisë. Pashë një shkëlqim të madh dhe një zë tha prej andej, ***“Rikardo, Rikardo, lëre punën tënde sepse dua të realizoj diçka me jetën tënde dhe me kishën time në Tokë.”*** Pasi dëgjova ato fjalë u trondita dhe menjëherë u zgjova nga ëndrra. Unë u çova dhe nisa të pyesja Perëndinë. “Çfarë do të thotë kjo Zot?”

Ky zë më erdhi fuqishëm dhe kjo ndodhi për disa ditë rresht. Me kalimin e ditëve zëri i Perëndisë në ëndërr sa vinte e bëhej më i fortë. Unë zgjohesha papritur dhe dridhesha. Prindërit më pyesnin, “Çfarë ke?” Unë u tregoja ëndrrën time dhe nëna ime lutej për mua. Ajo më tha, “Nëse Zoti po të flet, atëherë Ai do të të japë dituri.” Ne vazhdonim të luteshim gjithë natën deri sa vinte mëngjesi dhe koha për të shkuar në punë. Ne i kërkuam Zotit një shenjë, që të dinim nëse ishte Ai që po më fliste apo jo.

Unë punoja tek “Chile Laboratories”. Më pëlqente vërtetë puna ime. Unë shkoja në punë me autobus. Atë ditë, pasi zbrita nga autobusi dikush më tha menjëherë, “Çfarë bën ti këtu? Ti nuk duhet të jesh më në këtë vend.” Në raste të ndryshme, të tjerë më thoshin të njëjtën gjë dhe ata nuk ishin të krishterë. Kjo është shenja që Zoti më dha. Pas kësaj vendosa të lajmëroja shefin tim. I thashë, “Duhet ta lërë kompaninë sepse Zoti më ka urdhëruar të largohem.” Kur Zoti na urdhëron ne DUHET të bindemi. Shefi im u shqetësua për mua dhe pyeti, “Çfarë do të bësh më pas? Ku do të gjesh një punë

më të mirë se kjo?” Unë i thashë se duhet t'i bindesha Zotit. Kështu që ata organizuan një gosti lamtumire për mua. Pas kësaj unë mblodha gjërat e mia dhe shkova në shtëpi. Nëna ime po më priste, i thashë që e lashë punën time sepse Zoti më vërtetoi se ato ëndrra ishin prej Tij. Ajo u përgjigj, “Nëse Zoti të ka folur, atëherë le të bëjë me jetën tënde atë që dëshiron Ai.”



Hymë në shtëpi dhe biseduam deri në mbrëmje. Pastaj i thashë nënës sime që do shkoja në shtrat, sepse Zoti do të më fliste në një ëndërr. Unë mendoja kështu, por kjo nuk ndodhi. Ai do të merrej me mua ndryshe këtë herë. Kur shkova në shtrat dhoma ime filloi të dridhej. Unë nisa të bërtasë, “Është një tërmet që po godet Santiago (Kili).” U përpoqa të largohesha nga dhoma por ndjeja sikur dikush po më ndalonte që të dilja. Mund të shihja nënën dhe familjen time përtej dhomës dhe kërkova ndihmë por askush nuk mund të më dëgjonte. Tani e di se ishte një engjëll i Zotit që më ndalonte të dilja nga dhoma. U ktheva pas, shkova në shtrat dhe iu luta Perëndisë të më tregonte se çfarë po ndodhte.

Atëherë një zë i dëgjueshëm më foli. Fryma e Shenjtë filloi të më fliste me një zë shumë të bukur, “**Rikardo, tani që ke lënë punën tënde, dua që të shkosh në kishë dhe të lutesh shtatë orë çdo ditë, për jetën tënde dhe për kishën time në Tokë.**” Pasi Zoti përfundoi, dhoma pushoi së lëkunduri. Më pas munda të dilja nga dhoma. Vrapova tek nëna ime dhe i thashë, “Dëgjova zërin e Frymës së Shenjtë!” Dola nga shtëpia dhe nisa t’ua thosha këtë njerëzve të tjerë. Disa nuk besojnë se Perëndia u flet edhe sot njerëzve, por po ju them se është e vërtetë, Ai u flet shumë vetave! Nëse Zoti i fliste Abrahamit, Ai mund të na flasë edhe neve, kishës së Tij. Shkova në kishë e fola me peshkopin dhe u morëm vesh që kisha të hapej çdo mëngjes në orën 8 në mënyrë që unë të lutesha dhe t’i bindesha urdhrin të Perëndisë. Çdo mëngjes, unë shkoja në kishë dhe lutesha një orë, dy, tre dhe më pas nuk kisha më për çfarë të lutesha, prandaj pyeta Zotin, “Zot, për çfarë tjetër mund të lutem? Kam edhe katër orë të mbetura!”

Dëgjova një gjësim të nëndheshëm që fillonte nga dera e pasme e kishës. Ndjeva se kisha lëkundej sa majtas, djathtas si një njeri i dehur. Gjatë kësaj kohe Zoti më foli me zë të dëgjueshëm por jo me të njëjtin zë si në ëndërr. Zëri që më foli në ëndërr ishte një zë me autoritet, ndërsa këtë herë Ai më foli me një zë të trishtë. Ai tha, “**Rikardo, Rikardo, lutu për kishën time! Kisha ime nuk është më siç ka qenë!! Kisha ime në Tokë ka ndryshuar. Kisha ime e ka humbur besimin. Ajo nuk beson më tek Unë! Thuaji kishës sime që Unë jam i Vërtetë!! Ndërmjetëso për kishën time sepse kisha ime nuk lutet dhe nuk agjëron më!**” Lëkundjet pushuan pasi Ai përfundoi. Unë nisa të ndërmjetësoja dhe duke ecur lartë e poshtë kishës, lutesha që njerëzit e Perëndisë të rigjallërohen.

Të enjten e javës së dytë të lutjes, u zgjova me një dhimbje të fortë në kocka dhe kyçe dhe nuk ngrihesha dot. U çova me ndihmën e nënës sime, u bëra gati dhe shkova në kishë si çdo mëngjes. Atë mëngjes kishte shumë njerëz në kishë që luteshin. Unë u kërkova atyre të luteshin për mua për shkak të dhimbjeve në trupin tim. U thashë se isha shumë i dobët për tu lutur. Ata më vajosën dhe u lutën për mua dhe unë mora fuqi prej Perëndisë!! Aleluja! Fillova të lutesha, dhe i kërkova Zotit të kishte mëshirë për kombin e Kilit, për familjet, për njerëzit e varur nga droga dhe për kishën.

Pasi përfundova lutjen time, u largova dhe në mbrëmje u riktheva për një shërbesë. Pas bekimit të peshkopit, i ngrita duart lart dhe ndjeva se dikush më preku lehtë kurrizin. Në atë moment unë humba gjithë fuqinë dhe rashë në tokë. Peshkopi më pyeti se çfarë ndodhi dhe unë u përgjigja se nuk e dija.

Nuk kisha fuqi dhe flisja me vështirësi. Më pas njerëzit më rrethuan dhe nisën të luteshin në gjuhë, me zë të lartë. Pastaj disa nga ata panë një engjëll duke ardhur, i cili më kërkonte të lija trupin tim. Peshkopi deklaroi, *“Ti nuk do të largohesh nga trupi yt!”* Pasi ai e tha këtë, engjëlli ndaloi. Çdo person që ka autoritet në Krishtin nderohet nga engjëjt e Perëndisë.

Peshkopi më pas më pyeti, *“Për sa kohë engjëlli kërkon që ta lësh trupin tënd?”* Unë e pyeta engjëllin, *“Për sa kohë po më merr? Për një orë? Dy? Tre?”* Engjëlli u përgjigj, *“Jo, ti do të largohesh për 8 orë, për të takuar Jezusin në qiellin e tretë sepse Ai dëshiron të flasë me ty.”* Më pas engjëlli më tha, *“Nuk jam unë ai që do të të shoqërojë, sepse unë jam engjëlli yt mbrojtës, i cili të ka mbrojtur çdo ditë që ke jetuar në këtë tokë. Do të vij në dy engjëj nga parajsa dhe në mesnatë, do të të çojnë në qiellin e tretë.”* Ia tregova këtë peshkopit dhe ai vendosi të më çonte tek shtëpia e një pastori, në katin e dytë. Teksa rrija shtrirë në dhomë, ne dëgjuam nga jashtë njerëz që flisnin me zë të lartë.

Dy engjëj me rroba të shndritshme u shfaqën në rrugë dhe hynë në ndërtesën ku unë ndodhesha, në katin e dytë. Ata engjëj ishin shumë të bukur. Kishin flokë të bardhë të shndritshëm, më të bardhë se bora dhe sytë i kishin si perla. Lëkura e tyre ishte e lëmuar si lëkura e një fëmije, por trupat e tyre ishin muskulozë. Këta engjëj ishin shumë të fuqishëm!! I thashë peshkopit se këta engjëj janë dërguar për të më marrë në qiell. Njëri nga engjëjt bëri me shenjë që unë të lija trupin tim. Në këtë kohë kockat nisën të më dhembnin përsëri. Vëllezërit në Krishtin që gjendeshin pranë meje mu afruan dhe më thanë se trupi im po ftohej shumë. Ata sollën ngrohës për të më ngrohur. Ndërsa engjëjt po më thërrisnin, unë u dëshpërova dhe nisa të lëvizja nga njëra anë në tjetrën. Ndjeva se vdekja po më merrte dhe u thashë vëllezërve të mi në Krishtin, *“Mos më varrosni, sepse do të kthehem prapë!”*

Unë lashë trupin tim dhe pashë vëllezërit që po më preknin duke thënë, *“Ai ka ikur, është larguar nga trupi tij!”* Unë ndodhesha pranë tyre dhe thosha, *“Jam këtu!”* Megjithatë, ata nuk mund të më shihnin sepse isha në frymë, në një trup të paprishshëm. Njëri nga engjëjt më tha, *“Është koha të largohesh sepse Zoti po të pret!”* Secili nga engjëjt më mori nga njëra dorë dhe ata më çuan lart në qiell. Ne kaluam përmes atmosferës me shpejtësi rrufeje. Po ua tregoj këtë edhe nëse nuk më besoni, Jezus Krishti ekziston dhe jeton përgjithmonë!!

Më vonë, në fund të kësaj përvojë, kur Zoti më tha të kthehesha në trupin tim, unë i thashë, *“Cili është ai që do të më besojë, Zot, më lejo të rri me Ty!! Askush nuk do ta besojë këtë zbulesë, askush nuk do ta besojë këtë sepse njerëzit nuk kanë besim! Mungesa e besimit në tokë është e madhe, kush do ta besojë këtë përvojë?”* Zoti u përgjigj, *“Disa do ta besojnë historinë tënde, vetëm ata që i përkasin Kishës sime të vërtetë do të të besojnë.”*

Pasi lashë trupin tim atë natë dhe po fluturoja me shpejtësi për të takuar Zotin, mund të shihja nga lart planetin Tokë. Kalova më pas pranë hënës dhe pastaj pashë me sytë e mi diellin gjigand. Mund të shihja flakë që shpërthenin në sipërfaqen e diellit të cilat ngrohnin Tokën. Pastaj ne vazhduam dhe unë pashë shumë yje dhe kalova pranë tyre. Zoti më lejoi të shihja diellin, hënën dhe yjet për një arsye: që t’iu them të gjithë juve se Perëndia ynë është me të vërtetë një krijues i madh i universit!

Ne vazhduam të udhëtonim me shpejtësi të madhe deri sa mbërritëm në një vend ku nuk kishte më yje. Nuk kishte shenja të krijimit, vetëm errësirë. Unë mund të shihja gjithë yjet poshtë meje. U frikësova dhe pyeta engjëjt, *“Ku po më çoni? Ju lutem më ktheni në trupin tim në tokë!”* Ata më shtrënguan dhe më mbanin fort. Engjëjt thanë, *“Rri i qetë! Ne po të çojmë në qiellin e tretë ku Jezusi*

po pret për të folur me ty.” Engjëjt u ndalën dhe gjatë asaj kohe unë po vështroja në të gjitha drejtimet por nuk mund të shihja asgjë. Nuk e di ku ndodhesha por mendoj se isha në qiellin e dytë.

Papritur ndjeva një zhurmë të madhe sipër meje. Engjëjt më kapën fort dhe thanë, **“Rikardo, mos ki frikë, Jezusi është me ne!”** Ata thanë gjithashtu, **“Ktheje kokën dhe shih sipër teje!”** U çudita nga ajo që pashë sepse dukej sikur disa krijesa po lëviznin sipër nesh. Njëri nga engjëjt tha, **“Shiko, do të të tregojmë se çfarë po sheh sipër nesh!”** Dhe njëri nga engjëjt bëri shenjë me dorë dhe ndriçoi gjithë qiellin sipër që të shihja se çfarë kishte. Kur qielli u ndriçua pashë vetëm demonë dhe djaj që rrethonin gjithë qiellin. **ZOTI I DËBOFTË NË EMËR TË JEZUSIT!!**

Bibla është e vërtetë!! Ajo që po ndodh në Tokë është e shkruar tek Zbulesa. Jezusi vjen shpejt!! Si mund t’ju bindë për këtë? Ai vjen shumë SHPEJT.

Unë e pyeta engjëllin, **“Çfarë është ky vend?”** Njëri nga ata u përgjigj, **“Kjo është mbretëria e errësirës ku satani dhe engjëjt e tij banojnë.”** Unë thashë, **“Prandaj ka kaq shumë ligësi në tokë! Këta demonë vijnë në tokë prej këtej dhe shkaktojnë çfarëdo lloj shkatërrimi dhe paudhësie ndër njerëz”.** Toka është plot me demonë! Ka miliona e miliona, ata janë të panumërt.



Më pas engjëjt më thanë të shihja më nga afër dhe ata më treguan fytyrat e atyre krijesave dhe shumë prej atyre qenieve të tmerrshme i kemi parë tashmë në televizor. Ato qenie ishin tmerruese. Pashë “Thundercats”, “Power Rangers” dhe karikatura nga filmat vizatimorë dhe filmat horror. Të gjithë krijuesit e atyre filmave dhe animimeve kanë bërë një pakt me djallin për t’i prodhuar këto gjëra për televizionet dhe kinematë!! Të gjitha ato vizatime vijnë nga ajo botë frymore, të cilën unë përjetova. Përse mendoni se fëmijët sot janë kaq rebelë? Sepse ata demonë hyjnë



tek fëmijët tuaj teksa ata i shohin këto filma. Prandaj ne duhet t’i mësojmë fëmijët si të dallojnë e të zgjedhin se çfarë të shohin në televizor. Engjëlli më tregoi se e gjithë kjo është e vërtetë. Të gjithë ata demonë ekzistojnë dhe njerëzit po bëjnë pakt me djallin për t’i sjellë ata në tokë. Demonët nisën të mallkonin mua, kishën, Atin dhe Zotin Jezus dhe tokën sepse ata nuk respektojnë Perëndinë apo krijesat e Tij.

Pastaj, pashë të mishëruar një demon të quajtur Hugo, i cili është një karton i njohur në Kili. Ishte tmerrues ta shihje. Ai mu afrua dhe më tha, **“Ne do të shkojmë në Tokë dhe do t’i vrasim të gjithë fëmijët!”** A e mendoni përse fëmijët vrasin njëri tjetrin? Disa prej tyre kanë thënë se diçka doli prej televizorit dhe i urdhëroi të bënte këtë apo atë. Demonët po mbjellin urrejtje në Tokë, Zoti e çliroftë dhe e shpëtoftë Kilin!! Njëri nga engjëjt më tha, **“Vazhdo të shohësh!”** Dhe demonët thanë, **“Ne jemi përpjekur të shkatërrojmë kishën por nuk mundemi, sepse kur vrasim njërin, mijëra ngrihen për ta zëvendësuar vdekjen e tij!”** Që prej fillimeve të kishës, satani është përpjekur ta shkatërrojë atë, flas për kishën që predikon ungjillin e vërtetë dhe bën veprat e Perëndisë, ai nuk mundet ta shkatërrojë sepse Zoti Jezus na mbron! Lavdi Zotit!

Më pas demonët thanë, “*Le të bëjmë diçka të re, le të hyjmë brenda kishave sepse ka shumë njerëz atje që na përkasin neve! Do shkojmë t’i përdorim ata njerëz për të përhapur thashetheme dhe përçarje mes vëllezërve në kishë. Do bëjmë të mundur që kishat të rrëzohen prej thashethemeve, kështu që Fryma e Shenjtë do të hidhërohet dhe do ta lërë kishën.*” Djalli shkon kudo për të shkatërruar ata që duan drejtësinë e Perëndisë, siç thuhet në vargun:

1 Pjetrit 5:8

'Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë.'

Unë nuk doja të shikoja më, por engjëlli më udhëzoi të vazhdoja të shihja çfarë ndodhte përreth. Pashë që demonët u shpërhapën në të gjitha anët teksa një dritë e fortë si një yll po afrohej. Ndërkohë që kjo dritë po afrohej, ajo sillte falenderim dhe adhurim të madh për Perëndinë. Kjo dritë nuk ishte një yll por ishin miliona engjëj të hipur mbi kuaj të bardhë duke përlëvdur Zotin e Ushtrive! Ata thërrisnin, “***I Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë është Ai që jeton në shekuj të shekujve! Zoti është Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi, dhe çdo gjë që merr frymë le ta përlëvdojë Zotin!***” Më pas pashë një betejë të madhe dhe nuk i pashë më demonët. “*Mos ki më frikë sepse ka më shumë engjëj në anën tonë se në atë të armikut,*” thanë engjëjt.

Engjëjt krijuan një rrugë për në qiellin e tretë. Ata u ndanë në dy grupe, njëri në anën e djathtë dhe tjetri në të majtën. Ishte një rrugë e hapur për në qiellin e tretë! Kjo rrugë arrinte në Parajsë dhe unë mund të shihja qytetin qiellor të Perëndisë. Engjëj të lavdishëm kishin pastruar gjithë zonën nga demonët dhe nuk pushonin së falenderuari Perëndinë dhe së bekuari emrin e Tij! Engjëjt më vendosën përballë tyre dhe më thanë, “***Duhet të presësh këtu!***”

Pastaj pashë nga larg, në drejtim të qytetit qiellor dhe vërejtja dikë të veshur me rroba të bardha që kalëronte një kalë të bardhë. Ndërkohë që ai po më afrohej engjëjt vazhdonin të përlëvdonin dhe të lartësonin Perëndinë. Ai mu afrua dhe kur e pashë, ishte edhe më i bukur se engjëjt e tjerë. Ai më vështroi për pak kohë dhe tha me zë të lartë, “***Unë jam! Unë jam Mikaeli, kryeengjëlli që ka në ngarkim të të ruajë ty dhe kishën në Tokë!***” Unë e takova ballë për ballë engjëllin Mikael dhe ai ishte një qenie e çmuar. Ai u kthye dhe më tregoi rrugën për të hyrë në qytetin qiellor. Ai tha, “***Hyr! Zoti Jezus po të pret!***” Nisa të ecë drejt qytetit dhe ndërkohë engjëjt thërrisnin dhe përlëvdonin Zotin. Unë qaja vazhdimisht teksa shihja në drejtim të qytetit.

Qyteti ishte ndërtuar prej ari të pastër transparent dhe dyert e hyrjes ishin veshur me perla. Dyshemeja dukej e kristaltë. Nuk kisha parë asnjëherë diçka të tillë në tokë dhe asnjë njeri nuk mund ta ndërtojë këtë. Arkitekti ishte Zoti ynë, Perëndia i universit. Gjendesha jashtë qytetit dhe dyert e hyrjes ishin të hapura. Ato dyer janë ende të hapura. Unë mund të shihja brenda dhe në mure kishte gurë rubini dhe safiri dhe perla të shndritshme. Prej qytetit dëgjoheshin miliona e miliona zëra duke falenderuar Perëndinë! Unë u drodha kur e dëgjova këtë. Zërat thoshin, “***I Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë është Qengji i Perëndisë dhe Ati, të cilit i përket e gjithë lavdia dhe nderimi në shekuj të shekujve AMEN!***” Dëgjova më pas një zë të fortë që tronditi qiejt, “***JINI TË SHENJTË, SEPSE UNË JAM I SHENJTË! VETËM TË SHENJTËT DO TË HYJNË NË KËTË VEND! SEPSE PA SHENJTËRIM ASKUSH NUK DO TA SHOHË ZOTIN!***”

Pa shenjtërim askush nuk do ta shohë Atë.

Një zë tjetër tha, “**Hyr,**” dhe unë hyra në qytet. Dhe pashë një fron mahnitës prej të cilit dilte zjarr. Ndërsa zjarri dilte nga froni, vështrova dhe pashë Jezusin, Mbretin e mbretërve dhe Zotin e zotërve! Rashë për tokë përpara Tij pa asnjë fuqi. Ai shtriu dorën e tij dhe tha, “**Çohu në këmbë!**” Unë mora forcë dhe u ngrita. Kur pashë fytyrën e Tij, nuk ishte aspak si e përshkruajnë artistët në tokë në pikturat e tyre! Shumë njerëz bëjnë zotër prej druri dhe shumë imazhe të tjera. Por dua t’iu them vëllezër, se Jezusi nuk ngjante me ato imazhe! Ai ishte një Perëndi i fuqishëm, nuk ishte një Zot mediokër, Ai është i gjithëfuqishëm!! Ai tha, “**Unë nuk jam një Perëndi i bërë prej allçie apo druri, jam një Perëndi i gjallë që jeton!**” Ai vazhdoi, “**Thuajti kishës sime në tokë që Unë jam i vërtetë!! Unë jetoj dhe ekzistoj me të vërtetë! Thuajti njerëzve të mi që Parajsja është e vërtetë dhe që Unë po i pres!**”

Ai më tha, “**Eja, ec me mua sepse do të të tregoj diçka të madhe.**” Ne pamë poshtë dhe mund të shihnim tokën dhe çdo gjë që ndodhte atje. Jezusi tha, “**Unë jam në gjendje të shohë gjithçka që bën kisha ime!**” Ai di çdo gjë që ne bëjmë dhe unë mund të shihja nga Parajsja shumë prej atyre që njoh. Jezusi më tha, “**Shikoje kishën time!**” Pashë vëllezër kundër njëri-tjetrit dhe kisha kundër kishave të tjera. Jezusi më pas më tregoi, “**Kisha ime e ka humbur besimin, ata nuk duan të besojnë tek Unë, paudhësia është shumëfishuar në tokë dhe njerëzit nuk duan të besojnë se Unë ekzistoj. Thuajti njerëzve të mi që Unë do të bëj diçka të madhe në Tokë! Kisha ime po zbrapset në vend që të rritet.**” Zoti nisi të qajë për kishën e Tij dhe tha, “**Kjo kishë nuk është kisha ime!**” Unë thashë, “**Zot, mos fol në këtë mënyrë! Sigurisht që jemi kisha jote.**” Atëherë Zoti u përgjigj, “**Jo, kisha ime duhet të ecte në fuqi të madhe dhe shenja mrekullie! Kisha ime është zvogëluar! Megjithatë thuajti atyre se Unë do të kthehem për t’i ringritur përsëri!**”

Ai më tha të vazhdoja të ecja me Të dhe kaluam përmes një dere, sheshi poshtë ishte prej ari të kulluar. Nisa të vrapojë lart e poshtë rrugës prej ari dhe mblidhja pluhur të artë dhe e hidhja mbi trup. Zoti më tha të kthehesha dhe t’iu thosha se në Parajsë ka rrugë prej ari. “**Të gjitha këto janë për njerëzit e mi,**” tha Zoti, “**Por në kishën time ka shumë hajdutë që vjedhin të dhjetat dhe ofertat e mia! Thuajti njerëzve të mi që asnjë vjedhës nuk do të hyjë në Mbretërinë time në qiell!**” Ne duhet t’i drejtojmë jetët tona drejt Zotit.

Pastaj pashë një tryezë shumë të gjatë për miliona persona plot me ushqime dhe pije. Kishte gjithashtu shumë kurora dhe kupa kristali për të pirë. Zoti tha, “**Rikardo, e gjithë kjo është përgatitur për njerëzit e mi!**” Ajo ishte tryeza e përgatitur për dasmën e Qengjit.

Unë njoh një tjetër motër në Krishtin e cila ishte marrë gjithashtu në qiellin e tretë dhe kishte parë engjëjt që shkonin lart e poshtë duke përgatitur darkën e dasmës! Unë i thashë Zotit, “**Përse ajo i pa engjëjt duke bërë përgatitje, kurse unë nuk po i shoh?**” Zoti u përgjigj, “**Kjo sepse të gjitha përgatitjet kanë përfunduar!**” Kishte kurora për të gjithë ata që punojnë dhe i binden Zotit. Unë thashë, “**Zot, atëherë për sa kohë do të kthehesh? Edhe sa kohë ka ngelur në orën qiellore?**” E pyeta sepse shumë njerëz kanë parë në ëndërr një orë e cila tregonte pothuajse mesnatë, që simbolizonte kohën kur Zoti do të kthehet. Unë pyeta, “**Zot, kur do të shkojë ora e plotë? A ka ngelur edhe një minutë? Pesë minuta?**” Jezusi më vështroi për një çast pastaj u përgjigj, “**Rikardo, në qiell nuk ekziston më asnjë orë!**” Unë thashë, “**Zot, por nëse nuk ka më kohë, përse Ti nuk je kthyer ende?**” Jezusi ngriti duart lart dhe me gishtin e madh dhe tregues të njëjës dorë bëri shenjën e diçkaje shumë të vogël dhe tha, “**Koha që ka ngelur është thjesht hiri i Atit ndaj atyre që janë larguar nga rrugët e Tij, për tu ofruar atyre një mundësi që të pendohen dhe të kryejnë veprat e para.**” Zoti i Ushtrive nuk është kthyer sepse na

ka dhënë një hapësirë të vogël për tu penduar dhe kjo kohë quhet “Koha e hirit të Atit” Jezusi mund të vijë në çdo moment dhe ne duhet të fillojmë ta kërkojmë me gjithë zemrën tonë, të agjërojmë, të lutemi dhe të kryejmë veprat e para. ([Zbulesa 2:5](#)) Jezusi përsëriti, “**Jemi në kohën e hirit të Perëndisë!**”

Pastaj një engjëll u paraqit në të djathtë tonë dhe thirri, “**Koha erdhi!! Koha mbaroi. Çdo përgatitje ka përfunduar! Jezusi do të marrë nusen e Tij!**” Zoti po vjen dhe të gjitha shkrimet do të përmbushen. Shumë filma paraqesin se diçka katastrofike po afron. Shkencëtarët e dinë se diçka e madhe do të ndodhë. Ata thjesht nuk e dinë se çfarë është! Megjithatë ne, kisha e Tij, e dimë që Jezusi po vjen së shpejti! Kur engjëlli përfundoi thirrjen, miliona engjëj nisën të ngazëlleshin sepse nusja do të kthehet më në fund në Parajsë. Unë vazhdova të pyesja, “Çfarë po ndodh?” por askush nuk po më kushtonte vëmendje, ata të gjithë po gëzonin për lajmin e mirë. Kështu që u bashkova edhe unë me engjëjt dhe nisa edhe unë të lartësoja emrin e Jezusit! Në momentin kur çova duart, ndjeva se dikush më mori dhe më dërgoi poshtë me një shpejtësi shumë të madhe. Unë u ktheva në Tokë dhe u lëshova në katedrën e kishës ku lutesha çdo ditë.

Edhe tani engjëjt po ngazëlleshin për kthimin e nuses. **Koha është shumë e shkurtër!!** Në qoftë se nuk doni të më besoni atëherë mos besoni. Por Ai po kthehet!! Njerëzit e Perëndisë nuk duan të besojnë tek rrëmbimi i Kishës. Ju lutem për hir të Zotit, zgjohuni dhe pranoni të vërtetën!! ([Rikardo qan](#)).

Zoti ishte aty pranë meje dhe më tha, “**Rikardo, ja si do të dukej rrëmbimi nëse do të ndodhte në këtë moment!**” Unë mund të shihja gjithë tokën. Pashë Frymën e Shenjtë, të bukur e të çmuar, Ai i cili na jep paqe dhe gëzim po largohej nga Toka. Pastaj një mjegull hyri në kishë dhe më rrethoi. E pyeta Zotin, “Çfarë është kjo?” Ai tha, “**Kjo është ajo që Unë e quaj Rrëmbimi.**” Pashë pastaj njerëz që rrëzuan dyert e kishës të cilët donin të hynin brenda dhe bërtisnin, “*Ku janë fëmijët e mi? Kanë ikur të gjithë!*” Të gjithë fëmijët në tokë kishin ikur sepse Zoti nuk do të lërë asnjë pas. Ai që hyri i pari ishte drejtori i korit të kishës, duke thirrur, “*Ku është kisha? Unë jam lënë pas! Ngela! Ngela këtu!*” Pas drejtorit të korit, pashë pastorë të tjerë, vëllezër e motra dhe rojën e kishës të gjithë duke bërtitur, “*Unë u lashë pas!*” Shumë burra e gra po kërkonin për të dashurit e tyre dhe njerëzit në kishë iu përgjigjën, “*Të dashurit tuaj nuk janë këtu! Zoti i mori ata!*” Atëherë ata njerëz nisën të qajnë, “*Ishte gjithçka e vërtetë, Jezusi erdhi dhe mori nusen e tij!*”

Shumë njerëz po qanin dhe ishin të pikëlluar, ata donin të kishin besuar tek Jezus Krishti, sepse çdokush që nuk beson se Jezusi është Mesia, është i humbur. Unë pashë shumë njerëz dhe pastorë duke qarë dhe njerëzit nisën të pyesnin pastorët, “*Përse nuk më predikove të vërtetën, përse nuk më mësove shenjtërimin dhe nuk më paralajmërove për të gjitha këto? Për fajin tënd unë u lashë pas!*” Shumë veta do të lihen pas sepse ata nuk po jetojnë një jetë të shenjtë. Ne duhet të predikojmë shenjtërimin e vërtetë dhe tu mësojmë njerëzve të pendohen me të vërtetë! Pashë se si njerëzit rrihnin pastorët dhe i tërhiqnin prej flokësh. Pastorët qanin dhe u luteshin njerëzve të mos u bënin keq. Por njerëzit nuk ndalnin sepse tani ishin të demonizuar.

Kisha të tëra do të lihen pas. Pashë një vëlla që përpiquej të nxirrte sytë e tij për shkak të trishtimit. Njerëz të tjerë qëllonin me kokë muret sepse nuk mundën të kuptojnë se Jezusi ishte përgjigja e vetme. Sepse njerëzit deshën të vazhdonin në mëkat dhe paudhësi, dhe të jetonin siç dëshironin ata. Njerëzit prisnin mishin e tyre dhe qëllonin kokën deri sa binin në shesh. Pastaj pashë një të ri që thërriste Perëndinë, “*Të lutem Zot, më merr!*” Por ishte shumë vonë! Jezusi kishte ardhur dhe kishte marrë kishën e Tij. Unë rashë për tokë sepse pashë shumë gjëra të tmerrshme.

Jezusi më tha, **“Në kohën e shtrëngimit të madh, do të ketë trazira si asnjëherë më parë.”** Unë pyeta, **“Përse njerëzit çohen përsëri pasi e kanë dëmtuar veten kaq rëndë?”** Zoti Jezus u përgjigj, **“Sepse në atë kohë, njerëzit do ta dëshirojnë vdekjen, por nuk do ta gjejnë. Vdekja do të largohet nga Toka.”** E pyeta Zotin, **“Përse gjithë këta njerëz dhe pastorë ngelën pas?”** Dhe Zoti tha, **“Sepse Unë i njoh ata, Unë i njoh zemrat e tyre.”** Perëndia na njeh të gjithë. Ai i njeh zemrat tona. Jezusi tha, **“Desha të t’i tregoja të gjitha këto, në mënyrë që ti ta paralajmërosh kishën time dhe tu japësh atyre shpresë. Thuaju atyre që nëse pendohen tani, Unë do t’i falë ata, tani sa ka ende kohë. Do të bëj diçka të madhe në Tokë.”**

Ju lutem hapni sytë tuaj. Kisha ungjillore në Kili po rritet. **“Thuaju njerëzve të mi që nëse kërkojnë falje, Unë do t’i falë ata.”** tha Jezusi.

Më pas pata një vegim tjetër dhe pashë një zjarr që mbulonte gjithë qiellin. Jezusi tha, **“A e pe këtë? Ky zjarr që sheh mbi Tokë, është një zjarr mbi shtetin e Kilit. Sepse Kili do të jetë për Krishtin! Perëndia do ta ndryshojë Kilin!”** Unë pashë më pas që zjarri ra mbi Kilin dhe vende të tjera e panë dhe kuptuan se Zoti ishte atje. Dhe kisha të tëra mbi tokë u gëzuan për këtë. Jezusi tha, **“Sytë e Atit tim janë mbi Kilin.”** Zoti më mori në vegim dhe më çoi në një vend të quajtur “Paseo Humada” dhe më tregoi njerëz të gjymtuar dhe të çalë. Pastaj pashë besimtarë të vërtetë që luteshin për të gjymtuarit dhe urdhëronin gjymtyrët të rriteshin. Gjymtyrët u bindën dhe u rritën përpara syve të tyre. Gjatë asaj kohe, Zoti do të shfaqë mrekulli të vërteta. Njerëz nëpër kisha do të shërohen. Në ato ditë të vdekurit do të ringjallen dhe Perëndia do të kryejë nëpërmjet njerëzve të njëjtat mrekulli që kryenin edhe apostujt në Bibël.

Kjo është e gjithë zbulesa që Zoti më dha. (Ricardo Cid). Ai vjen shpejt. Amen!

